

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA KROI DHE NOCKA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 84056/17)

VENDIM

Neni 6 § 1 (aspekti civil) – Gjykatë e paanshme – Pjesëmarrja e tre gjyqtarëve në proceset e Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me të drejtat e pronësisë së kërkuesve, pasi kanë qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në të njëjtën çështje – Gjyqtarët vendosën nëse ata vetë kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave kushtetuese të kërkuesve - Vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese kishin të bënin ngushtësisht me çështje materiale të lidhura - Gjyqtarët përkatës votuan për rrëzimin e ankimit kushtetues të kërkuesve në trup gjyqësor të ndarë me barazim votash – Ekzistenca e frikës së përligjur në mënyrë objektive për mungesën e paanshmërisë – Mosadresimi nga Gjykata Kushtetuese, nëse mungesa e pretenduar e paanshmërisë përligjte përjashtimin e gjyqtarëve ose ndikonte në aftësinë e tyre për të marrë vendim për çështjen – Vlerësimi i kërkuar procedural nuk është kryer – Mangësitë strukturore në lidhje me plotësimin në kohë të vendeve vakante në trupën e Gjykatës Kushtetuese kontribuan që çështja të shqyrtohej nga një trup gjyqësor jo e plotë – Proceseve të kundërshtuara u mungonin garancitë e nevojshme të paanshmërisë Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG

26 gusht 2025

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit të Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Kroi dhe Nocka kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *President*,
Peeter Roosma,
Darian Pavli,
Úna Ní Raifeartaigh,
Mateja Đurović,
Canòlic Mingorance Cairat,
Vasilka Sancin, *gjyqtarë*,
dhe Milan Blaško, *Kancelar i Seksionit*,
Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 84056/17) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga dy shtetas shqiptarë, z. Agim Kroi dhe z. Albert Noçka (“kërkuesit”), më 16 dhjetor 2017;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) për ankimet e kërkuesve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës që pretendojnë mungesën e paanshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe shkelje të të drejtave të tyre për t’iu

drejtuar gjykatës, dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre, dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 1 korrik 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me ankimet e kërkuessve për shkelje të së drejtës së tyre për një gjykatë të paanshme nga Gjykata Kushtetuese, shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe shkelje të së drejtës së tyre për t'iu drejtuar gjykatës, për shkak të votave të barabarta në Gjykatën Kushtetuese. Çështja ka të bëjë, gjithashtu, me ankimin e mëtejshëm të kërkuessve për ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre.

FAKTET

2. Kërkuessit kanë lindur në vitet 1951 dhe 1952 përkatësisht dhe jetojnë në Tiranë. Ata përfaqësohen nga z. S. Puto, avokat me licencë në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjentët e asaj kohe znj. A. Hicka dhe z. A. Metani dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen, si më poshtë.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Më 26 gusht 2000, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës ("Komisioni") njohu pronësinë e N.N. mbi një truall toke me sipërfaqe 1,176 metra katrorë dhe i dha asaj kompensim të pjesshëm, duke i kthyer një truall toke me sipërfaqe 974 metra katrorë. Pjesa e mbetur prej 202 metrash katrorë do të kompensohej në njërin nga mënyrat e parashikuara me ligj. Ajo, gjithashtu, do të kishte të drejtën e parablerjes, në lidhje me një ndërtesë të ndodhur në truall. Për më tepër, një ndërtesë e përdorur nga një stacion televiziv privat do t'i kthehej asaj dhe më pas ajo do të merrte pagesat e qirasë, sipas një kontrate qiraje ndërmjet stacionit televiziv dhe autoriteteve publike. Më 26 tetor 2000, N.N. ua shiti truallin kërkuessve, të cilët e regjistruan titullin e tyre të pronësisë në Regjistrin e Tokave.

6. Më 1 qershor 2007, Zyra e Avokatit të Shtetit kërkoi anulimin e vendimit të Komisionit të vitit 2000 me arsyetimin se prona nuk kishte qenë e lirë në kohën e kthimit, por kishte qenë (dhe vazhdonte të ishte) e zënë nga një qendër sportive publike. Më tej, ajo argumentoi se, në kohën kur Komisioni kishte marrë vendimin e tij, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ("Ministria") kishte nënshkruar tashmë një kontratë qiraje afatgjatë me një palë të tretë për pronën.

7. Më 8 gusht 2007, Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ("Agjencia"), autoriteti administrativ që kishte zëvendësuar Komisionin, shfuqizoi vendimin e vitit 2000. Ajo njohu pronësinë e N.N. mbi truallin me sipërfaqe 1,176 metra katrorë dhe, duke e konsideruar truallin të papërshtatshëm për kthim, vendosi që ajo të kompensohej në njërin nga mënyrat e parashikuara me ligj. Titulli i pronësisë së kërkuessve u hoq nga Regjistri i Tokave.

8. Më 29 maj 2008, prona iu shit kompanisë M., qiramarrës sipas kontratës së qirasë me Ministrinë dhe u lëshua një leje ndërtimi për një ndërtesë shumëkatëshe.

9. Kërkuessit kundërshtuan vendimin e Agjencisë para Gjykatës së Rrethit të Tiranës ("Gjykata e Rrethit"), duke argumentuar se kompetenca e Agjencisë për të rishikuar dhe shfuqizuar vendimet e Komisionit me iniciativën e saj ishte shpallur ndërkohë jokushtetuese (shih paragrafin 36 më poshtë). Përveç kësaj, në kundërshtim me argumentet e të paditurve, prona në fjalë nuk po përdorej për qëllime publike dhe për këtë arsye nuk kishte pasur pengesë ligjore për kthimin e saj.

10. Më 31 maj 2010, Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesën e kërkuessve për shfuqizimin e vendimit të Agjencisë, duke konstatuar se trualli në fjalë nuk kishte qenë i kualifikuar për kthim. Gjykata vuri në dukje më tej se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 26 majit 2010 (shih

36 dhe 37 më poshtë) nuk ishte botuar ende në Fletoren Zyrtare dhe për këtë arsye nuk ishte ende i zbatueshëm. Më 4 maj 2011, Gjykata e Apelit të Tiranës la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

11. Kërkuesit depozituan një ankim për pika të ligjit në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se vendimi i Agjencisë – i nxjerrë nga drejtori i saj – kishte shkelur të drejtat e tyre kushtetuese dhe ishte miratuar në shkelje të ligjit. Ata argumentuan më tej se vendimet e gjykatave më të ulëta nuk kishin qenë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 26 majit 2010 (shih paragrafët 36 dhe 37 më poshtë).

12. Në korrik 2012, Gjykata e Lartë, në një trup gjykues me pesë anëtarë, rrëzoi ankimin e kërkuesve për çështjet *de plano*, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë argument të pranueshëm, në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

13. Kërkuesit paraqitën një ankim kushtetues, duke pretenduar mungesë paanshmërie nga ana e Gjykatës së Lartë, shkelje të së drejtës së tyre për t'u dëgjuar gjatë proceseve administrative dhe shkelje të parimit të sigurisë juridike.

14. Më 21 mars 2013, Gjykata Kushtetuese pranoi ankimin kushtetues të kërkuesve dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të së drejtës së kërkuesve për një gjykatë të paanshme, pasi një nga anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, gjyqtari G.Z., ishte ish-Avokati i Shtetit, i cili kishte kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vitit 2000. Gjykata Kushtetuese nuk ishte në gjendje të vendoste për ankimin e kërkuesve, në lidhje me parimin e sigurisë juridike për mosarritjen e shumicës së kërkuar prej pesë anëtarësh, pasi vetëm katër nga gjashtë anëtarët e panelit votuan për ta pranuar atë.

15. Më 3 mars 2016, Gjykata e Lartë rrëzoi për herë të dytë rekursin për çështje ligjore të paraqitur nga kërkuesit, në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (pa arsye të vlefshme për rekurs).

16. Më 15 shkurt 2016, kërkuesit paraqitën një ankim të ri kushtetues në Gjykatën Kushtetuese. Ata u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për t'u dëgjuar gjatë proceseve administrative. Ata pretenduan më tej për shkelje të parimit të sigurisë juridike, me arsyetimin se pronësia e tyre mbi truallin ishte përcaktuar tashmë me vendimin përfundimtar të Komisionit dhe se gjykatat kishin pasur detyrimin të vepronin në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 26 majit 2010.

17. Gjykata Kushtetuese i njoftoi kërkuesit dy herë për shtyrjen e seancës së çështjes së tyre, e cila ishte caktuar përkatësisht për 22 qershor dhe 27 qershor 2017. Seanca e parë u shty, sepse gjyqtarja V.T. ishte vetëpërrjashtuar, duke qenë se më parë kishte shërbyer si avokate e kërkuesve. Seanca e dytë u shty për “arsye objektive” të paspecifikuara.

18. Më 24 korrik 2017, Gjykata Kushtetuese, me dyer të mbyllura në një formacion me gjashtë nga nëntë gjyqtarë, e rrëzoi përfundimisht ankimin kushtetues të kërkuesve pas një ndarjeje të votave tre me tre. Gjykata deklaroi se që kjo kërkesë të miratohet nevojitet shumica prej pesë votash sipas nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Nëse nuk arrihej kjo shumicë, kërkesa duhej të konsiderohej përfundimisht e *rrëzuar*. Tre anëtarë të trupit gjykues, gjyqtarët B.I., G.D. dhe F.L., të cilët të gjithë kishin qenë pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në vitin 2012, votuan për rrëzimin e ankimit kushtetues të kërkuesve.

II. PËRBËRJA E GJYKATËS KUSHTETUESE

19. Dy gjyqtarë nuk morën pjesë në gjykimin e çështjes së kërkuesve: Gjyqtarja V.T., e cila e kishte përrjashtuar veten për shkak se ishte ish-avokatja e tyre; dhe gjyqtarja A.Xh., e cila mungonte për arsye të paspecifikuara. Duket se ajo u rikthye në punë në shtator 2017. Pozicioni i gjyqtarës S.B., e cila kishte dhënë dorëheqjen në shtator 2016, ishte ende vakant në atë kohë.

20. Ish-gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (gjyqtarët B.I., G.D. dhe F.L.), të cilët kishin shqyrtuar çështjen e kërkuesve në vitin 2012 u emëruan gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese në të njëjtën kohë, pas përfundimit të mandatit të tyre në Gjykatën e Lartë.

21. Sa u përket mandateve të gjyqtarëve të tjerë, mandati i gjyqtarit V.K. përfundoi më 25 prill 2016, por ai vazhdoi të ushtronte detyrat e tij deri më 2 gusht 2017, kur dha dorëheqjen. Ai mori pjesë në seancën gjyqësore të çështjes së kërkuesve.

22. Në shkurt 2018, Presidenti i Republikës hapi procedurën për emërimin e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese për të plotësuar pozicionin e mbajtur më parë nga gjyqtari S.B. Ky vend i lirë u plotësua në tetor 2019 nga gjyqtari B.M., i cili u shkarkua disa javë më vonë për shkak se nuk kaloi procesin e vetingut. Në dhjetor 2020 ai u zëvendësua nga gjyqtarja S.Bj.

23. Në nëntor 2019, Parlamenti (këtu e më poshtë “Kuvendi”) emëroi gjyqtaren E.T. për të zëvendësuar gjyqtarin V.K. (shihni paragrafin 21 më lart).

24. Si rezultat i dorëheqjeve dhe/ose shkarkimeve nga organet e vetingut, Gjykatës Kushtetuese i mungonte kuorumi për rishikimin me trup gjykues të plotë nga 23 marsi 2018 (kur gjyqtari F.L. u pezullua dhe më vonë u shkarkua nga organet e vetingut) deri më 23 dhjetor 2020 (kur u emërua anëtari i gjashtë i ri, gjyqtari P.K.).

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE DHE MATERIALI NDËRKOMBËTAR

I. PRAKTIKA DHE LEGJISLACIONI I BRENDSHËM

A. Kushtetuta

25. Pjesët përkatëse të Kushtetutës Shqiptare lexojnë, si më poshtë:

Neni 125

“1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.

2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

...

6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Neni 127

...

“3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.”

Neni 179

“1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, sipas mandatit të mëparshëm.

2. Anëtari i parë për t’u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet e ardhshme të bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.”

B. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe 45/2021

26. Gjykata vendos për themelin e ankimeve individuale në trup gjykues të plotë. Kuorumi i seancës plenare është dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve, ose gjashtë gjyqtarë (neni 32(1)).

27. Një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese duhet të kërkojë përjashtimin e tij ose të saj nga shqyrtimi i një çështjeje specifike, kur ai ose ajo ka shprehur publikisht qëndrimin e tij ose të saj në lidhje me çështjen, ose kur paanshmëria e tij ose e saj vihet në diskutim për arsye të tjera (neni 36(1)(b) dhe (ç)).

28. Në këto raste, gjyqtari, brenda një afati të arsyeshëm, i paraqet me shkrim kërkesën për heqjen dorë nga çështja kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për heqje dorë ose për përjashtimin nga gjykimi shqyrtohet menjëherë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendos për pranimin ose jo të saj (neni 36(3)).

29. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit në çdo fazë të zhvillimit të gjykimit, kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes (neni 37(1)). Për përjashtimin e gjyqtarit vendos shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, pasi dëgjohet nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, gjyqtari quhet i përjashtuar.

30. Njoftimi për orën dhe datën e zhvillimit të *seancës plenare*, publike ose *mbi bazë të dokumenteve*, bëhet, si rregull, 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare, me përjashtim të rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe (neni 38(1)).

31. Kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi dhe e prapësimeve nga subjekti/et i/e interesuar/a passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe të dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit (neni 38(6)).

32. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet (neni 72(2)).

33. Neni 73(4) i ligjit parashikon që “kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e *rrëzuar*”.

C. Kodi i Procedurës Civile (“KPC”)

34. Dispozitat përkatëse të KPC-së në fuqi në kohën e ngjarjes, lexojnë, si më poshtë:

Neni 472

Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet rekurs

Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur:

- a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;
- b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi);
- c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë miratimin e vendimit.

...”

D. Ligji për pronat 2004 (ligji nr. 9235/20024 – siç ishte në fuqi në kohën në fjalë)

35. Më 6 shkurt 2007, ligji për pronat i vitit 2004 u ndryshua (ligji nr. 9684). Në veçanti, neni 18 i ligjit u riformulua, në lidhje me tre pika kryesore. Së pari, Zyrës së Avokatit të Shtetit iu dha e drejta për të paraqitur një ankim në zyrën qendrore të Agjencisë kundër vendimeve të degëve rajonale të Agjencisë. Këto ankime duhej të paraqiteshin brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi. Së dyti, Zyrës së Avokatit të Shtetit iu dha e drejta për të paraqitur një ankim në zyrën qendrore të Agjencisë kundër vendimeve përfundimtare të ish-komisioneve. Nuk u parashikua asnjë afat kohor për këto ankime. Së treti, drejtori i Agjencisë qendrore u autorizua të rishikonte dhe potencialisht të shfuqizonte, me nismën e tij ose të saj, vendimet përfundimtare të ish-komisioneve të pronave dhe degëve rajonale të Agjencisë. Nuk u parashikua asnjë afat kohor për këtë rishikim.

E. Praktika e Gjykatës Kushtetuese

36. Më 26 maj 2010, Gjykata Kushtetuese nxori një vendim që shpalli jokushtetuese kompetencën e Agjencisë për të rishikuar kryesisht vendimet e mëparshme përfundimtare.

37. Ajo arsyetoi se një kërkesë e paraqitur në një komision pronash ishte ekuivalente me një kërkesë në gjykatë dhe se, për këtë arsye, vendimet e komisioneve krijonin të njëjtat pritshmëri si vendimet e gjykatës. Ato nuk ishin thjesht akte administrative, por vendime kuazi-gjyqësore. Nga kjo vijon që vetëm një autoritet gjyqësor, jo një autoritet administrativ si Agjencia, mund të shqyrtonte një kërkesë për rishikimin e vendimit të një komisioni pronash.

38. Pas këtij vendimi, më 22 korrik 2010, Parlamenti prezantoi ndryshime në ligjin e vitit 2004 për pronat, duke i rikthyer Agjencisë qendrore kompetencën për të rishikuar vendimet e mëparshme të komisioneve. Më 6 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese i gjeti këto dispozita jokushtetuese, në thelb për të njëjtat arsye si ato të përshkruara më sipër.

II. MATERIAL NDËRKOMBËTAR PËRKATËS

A. Opinion për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese i miratuar nga Komisioni i Venecias më 19 qershor 2020

39. Pjesët përkatëse të opinionit për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë janë, si më poshtë:

“23. Gjyqtari Berberi dha dorëheqjen nga detyra më 14.9.2016, ndërsa gjyqtari Kristo ishte ende në detyrë. Vendi i tij vakant ishte, pra, i pari që u materializua në rend kronologjik, kështu që, për vijueshmëri, pasardhësi i tij ishte pjesë e kuotave të Presidentit. Pasardhësi i gjyqtarit Kristo më pas ishte pjesë e kuotave të Kuvendit.

...

31. Gjykata e Lartë, për shkak të vetingut të anëtarëve të saj, për një kohë mjaft të gjatë kishte vetëm një gjyqtar në detyrë nga 19 gjyqtarë; ky gjyqtar kishte qëndruar në detyrë pas mbarimit të mandatit të tij në shkurt 2014. Kështu, Gjykata e Lartë nuk e kishte kuorumin për të zgjedhur tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, që bënë pjesë në kuotën e saj. Megjithatë, më 10.3.2020, tre gjyqtarë të rinj të Gjykatës së Lartë u betuan te Presidenti”.

B. Material në lidhje me gjyqësorin

40. Tekstet ndërkombëtare përkatëse, siç janë fragmente nga Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësore mund të gjenden në *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë* (nr. 16812/17, § 224, 18 korrik 2019) dhe *Harabin kundër Slovakisë* (nr. 58688/11, §§ 107-08, 20 nëntor 2012).

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR NJË GJYKATË TË PAVARUR

41. Bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuessit u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për gjykatë të paanshme nga Gjykata Kushtetuese.

42. Neni 6 § 1 i Konventës, aty ku është relevante, lexon, si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj ...”

A. Pranueshmëria

43. Qeveria parashtroi se kërkuessit kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për një gjykatë të paanshme, duke mos kërkuar përjashtimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të përfshirjes së tyre të mëparshme në shqyrtimin e çështjes së tyre para Gjykatës së Lartë. Kërkuessit e dinin se tre gjyqtarët do të ishin në trupin gjykues të Gjykatës Kushtetuese, duke pasur parasysh se çështja e tyre do të shqyrtuhej nga i gjithë trupi gjykues. Meqenëse përbërja e Gjykatës Kushtetuese ishte informacion publik, u takonte kërkuessve që të kërkonin përjashtimin e tre gjyqtarëve nëse dyshonin për paanshmërinë e tyre.

44. Kërkuesit nuk ranë dakord. Ata pretenduan se, duke marrë parasysh dispozitat ligjore në fuqi, ata kishin pritur që tre gjyqtarët të vetëpërrjashtoheshin, meqë ata kishin qenë pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në vitin 2012.

45. Gjykata vlerëson se kundërshtimi i Qeverisë lidhet me themelin e ankimit të kërkuesve dhe për këtë arsye vendos ta bashkojë atë me themelin.

46. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

47. Kërkuesit pretenduan se pjesëmarrja e gjyqtarëve B.I., G.D. dhe F.L. në proceset para Gjykatës Kushtetuese kishte shkelur të drejtën e tyre, që çështja e tyre të dëgjohej nga një gjykatë e paanshme, sepse të njëjtët gjyqtarë kishin gjykuar edhe ankimin e tyre para Gjykatës së Lartë në vitin 2012. Gjyqtarët kishin gjykuar në mënyrë efektive të njëjtën çështje dy herë, duke përfshirë të njëjtat palë, të njëjtat fakte dhe të njëjtën mosmarrëveshje. Në kërkesën e tyre para Gjykatës së Rrethit, ata kishin ngritur të njëjtat argumente të ngritura në ankimin e tyre për çështje ligjore dhe më vonë në ankimin e tyre kushtetues, duke pretenduar shkelje të parimit të sigurisë juridike, ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzim paqësor të pasurisë së tyre dhe shkelje të së drejtës së tyre për t'u dëgjuar. Pra, sipas tyre, gjyqtarët në fjalë nuk mund të konsideroheshin të paanshëm. Për më tepër, duke pasur parasysh që Gjykata Kushtetuese ishte mbledhur në një trup gjykues prej gjashtë nga nëntë gjyqtarësh dhe numri minimal i votave të kërkuara për të gjetur shkelje ishte pesë anëtarë, pjesëmarrja e tre gjyqtarëve të pjesshëm ishte vendimtare dhe në gjendje të ndikonte në të gjithë rezultatin e çështjes. Si rezultat, i gjithë trupi gjykues nuk mund të konsiderohej i paanshëm.

48. Lidhur me heqjen dorë nga e drejta e tyre për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve, kërkuesit pretenduan se Gjykata Kushtetuese nuk kishte zhvilluar një seancë gjyqësore në çështjen e tyre. Prandaj, ata nuk kishin pasur asnjë mënyrë se si ta dinin që tre gjyqtarët nuk ishin vetëpërrjashtuar nga proceset.

49. Qeveria, nga ana e saj, pretendoi se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në faza të ndryshme të procesit nuk përbënte, në vetvete, shkelje të së drejtës për një gjykatë të paanshme. Juridiksioni i Gjykatës së Lartë ndryshonte nga ai i Gjykatës Kushtetuese dhe, prandaj, arsyet mbi të cilat anëtarët e secilit organ gjyqësor përkatës duhej të shprehnin qëndrimet e tyre, gjithashtu, ndryshonin. Rekursi i kërkuesve për çështje ligjore kishte të bënte me interpretimin e ligjit për pronat nga organet administrative, ndërsa ankimi kushtetues kishte të bënte me të drejtën e tyre për gjykim të drejtë. Për më tepër, Qeveria theksoi se në vitin 2017, Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 2016, një vendim ku nuk kishin marrë pjesë tre gjyqtarët, paanshmëria e të cilëve tani po kundërshtohej nga kërkuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Paanshmëria

50. Si rregull, paanshmëria tregon mungesën e paragjykimit ose anshmërisë. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet, sipas: i. një testi subjektiv, ku duhet të merret parasysh bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar – domethënë, nëse gjyqtari kishte ndonjë paragjykim ose anshmëri personale në një çështje të caktuar; dhe ii. një testi objektiv, domethënë, duke konstatuar nëse, pavarësisht nga sjellja personale e ndonjërit prej anëtarëve të saj, vetë gjykata dhe, mes aspekteve të tjera, përbërja e saj, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim, në lidhje me paanshmërinë e saj (shih, mes vendimeve të tjera, *Micallef kundër Maltës* [DHM], nr. 17056/06, § 93, GJEDNJ 2009, me referenca të mëtejshme). Megjithatë, nuk ka një ndarje të qartë ndërmjet paanshmërisë subjektive dhe objektive, sepse

sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të nxisë dyshime objektive, në lidhje me paanshmërinë e gjykatës nga pikëpamja e vëzhguesit të jashtëm (testi objektiv), por edhe mund të prekë çështjen e bindjes personale të gjyqtarëve (testi subjektiv) (shih *Kyprianou kundër Qipros* [DHM], nr. 73797/01, § 119, GJEDNJ 2005 XIII). Kështu, në disa raste ku mund të jetë e vështirë të sigurohen prova me të cilat të kundërshtohet supozimi i paanshmërisë subjektive të gjyqtarit, kërkesa e paanshmërisë objektive ofron një garanci të mëtijshme të rëndësishme (shih *Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 10 qershor 1996, § 32, *Raportet e vendimeve* 1996-III). Në këtë drejtim, edhe paraqitja e jashtme mund të jetë e një rëndësie të caktuar ose, me fjalë të tjera, “drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por duhet edhe të shihet se po bëhet”. Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat duhet të frymëzojnë te publiku në një shoqëri demokratike (shih *Morice kundër Francës* [DHM], nr. 29369/10, § 78, GJEDNJ 2015, dhe *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], nr. 76639/11, §§ 61-63, 25 shtator 2018).

51. Vlerësimi, nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të një çështjeje civile përputhet me kërkesën e paanshmërisë të përcaktuar nga neni 6 § 1 duhet të bëhet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes individuale dhe, ajo që është më e rëndësishme, karakteristikat e rregullave përkatëse të procedurës të zbatuara për çështjen. Në veçanti, është e nevojshme të merret në konsideratë, nëse lidhja ndërmjet çështjeve thelbësore të përcaktuara në faza të ndryshme të procedurës është aq e ngushtë sa të hedhë dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit që merr pjesë në vendimmarrje në këto faza (shih *Indra kundër Sllovakisë*, nr. 46845/99, §§ 51-54, 1 shkurt 2005; shih edhe, *mutatis mutandis*, *Warsicka kundër Polonisë*, nr. 2065/03, § 40, 16 janar 2007, *Toziczka kundër Polonisë*, nr. 29995/08, § 36, 24 korrik 2012; dhe, në lidhje me procesin e shqyrtimit kushtetues, *Scerri kundër Maltës*, nr. 36318/18, § 76, 7 korrik 2020).

52. Duke iu referuar rrethanave të çështjes aktuale, Gjykata vëren se shqetësimet e kërkuarve në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës Kushtetuese buronin nga fakti që gjyqtarët B.I., G.D. dhe F.L., të cilët kishin qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në vitin 2012 në të njëjtën çështje, morën pjesë, gjithashtu, në proceset para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata pajtohet që kjo situatë mund të kishte ngritur dyshime në mendjen e kërkuarve, në lidhje me paanshmërinë e asaj gjykate. Prandaj, ajo duhet të përcaktojë nëse këto dyshime ishin të përligjura objektivisht, gjë që varet nga rrethanat specifike të çështjes. Në këtë drejtim, Gjykata e vlerëson të përshtatshme të shqyrtojë, nëse ekziston një lidhje e ngushtë ndërmjet çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë që trajtoi ankimin për çështje ligjore në vitin 2012 dhe atyre të trajtuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj të vitit 2017.

53. Gjykata vëren, se më 11 korrik 2012, Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin e kërkuarve për çështje ligjore. Çështja kryesore ligjore në kërkesën e tyre para Gjykatës së Rrethit lidhej me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tyre të pronësisë dhe parimin e sigurisë juridike, për shkak të shfuqizimit të vendimit të Komisionit dhe mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2010. Të dyja këto çështje u ngritën në rekursin e kërkuarve për çështje ligjore dhe, për këtë arsye, Gjykatës së Lartë iu kërkuar që t'i trajtonte ato. Megjithatë, vendimi i Gjykatës së Lartë, duke qenë një vendim *de plano*, nuk përmbante asnjë arsyetim të detajuar në përgjigje të rekursit të kërkuarve. Ajo e shpalli rekursin e tyre për çështje ligjore të papranueshëm në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, duke përmendur mungesën e shkaqeve të vlefshme për ankim. Kjo, në fakt, rezultoi në një vendim që gjykatat e shkallës së parë e kishin zbatuar saktë ligjin material (shih paragrafin 34 më sipër).

54. Pasi Gjykata Kushtetuese kishte gjetur shkelje të së drejtës së kërkuarve për një gjykatë të paanshme dhe ia kishte kthyer çështjen Gjykatës së Lartë për një shqyrtim të ri, ajo gjykatë duhej të trajtonte të njëjtat çështje si ato të trajtuara më parë në vitin 2012.

55. Gjykata vëren se gjyqtarët B.I., G.D. dhe F.L. ishin pjesë e trupit gjykues të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2017. Asaj gjykate iu kërkua të vendoste nëse trajtimi i çështjes së kërkuarve nga gjykatat e shkallës së parë ishte në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese.

Ndonëse është e vërtetë që ankimi kushtetues i shqyrtuar nga tre gjyqtarët kishte të bënte me vendimin e Gjykatës së Lartë të vitit 2016, të dyja vendimet e Gjykatës së Lartë të viteve 2012 dhe 2016 kishin të bënin me të njëjtin rekurs për çështje ligjore dhe ndoqën të njëjtën qasje ndaj tij. Kështu, të njëjtët gjyqtarë që ishin në trupin gjykues të Gjykatës Kushtetuese u thirrën për të vendosur nëse ata vetë kishin mbajtur më parë një qëndrim që kishte kontribuar në shkeljen e të drejtave kushtetuese të kërkuësve (shih *Scerri*, i cituar më sipër, § 78). Për më tepër, duke pranuar natyrën e ndryshme të procesit në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata vëren se në këtë çështje, vendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese kishin të bënin me çështje thelbësore të lidhura ngushtë, kryesisht në lidhje me respektimin e parimit *res judicata*, rrëzimin e vendimit të Komisionit dhe pajtueshmërinë me precedentët e mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese.

56. Kur vendoset nëse, në një rast të caktuar, ekziston një arsye legjitime për të pasur frikë që një organ i caktuar nuk është i paanshëm, pikëpamja e atyre që pretendojnë se nuk është i paanshëm është e rëndësishme, por jo vendimtare. Ajo që është vendimtare është nëse frika mund të konsiderohet e përligjur objektivisht (shih *Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë*, 7 gusht 1996, § 58, *Raportet* 1996-III; *Wettstein kundër Zvicrës*, nr. 33958/96, § 44, GJEDNJ 2000-XII; *Kyprianou*, i cituar më sipër, §§ 118-119; dhe *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, § 76, GJEDNJ 2007-V (ekstrakte)). Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e tre gjyqtarëve në fjalë – në një formacion prej gjashtë gjyqtarësh – në gjykimin e çështjes, Gjykata konstaton se rrethanat e përshkruara më sipër janë të mjaftueshme për të vlerësuar që kërkuësit kishin arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë paanshmërie nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Kjo çështje bëhet edhe më tej e rëndësishme nga fakti që po ata tre gjyqtarë votuan në favor të rrëzimit të ankimit kushtetues të kërkuësve, në një trup gjykues me barazi votash.

57. Prandaj, Gjykata do të vlerësojë nëse gjyqtarët kishin detyrimin të përjashtonin veten dhe çfarë ndikimi do të kishte pasur përjashtimi i tyre te trupi gjykues.

b) Përjashtimi i gjyqtarëve dhe doktrina e domosdoshmërisë

58. Në këtë drejtim, duhet theksuar se çdo gjyqtar për të cilin ka një arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë paanshmërie duhet të tërhiqet (shih *Micallef*, cituar më sipër, § 98). Paanshmëria e gjyqtarëve (*nemo iudex in causa sua*) është në fakt një nga parimet themelore të një Shteti ku sundon ligji.

59. Ekzistenca e procedurave kombëtare për sigurimin e paanshmërisë, përkatësisht rregullave që rregullojnë tërheqjen e gjyqtarëve, është një faktor i rëndësishëm. Këto rregulla manifestojnë shqetësimin e legjislaturës kombëtare për të hequr të gjitha arsyet e bazuara në dyshim, në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit ose gjykatës përkatëse dhe përbëjnë një përpjekje për të siguruar paanshmërinë, duke eliminuar shkaqet e këtyre shqetësimeve (shih *Harabin*, cituar më lart, §§ 130-32 dhe 135-40). Gjykata Kushtetuese u mbledh në trup gjykues me gjashtë nga nëntë gjyqtarë (trupa e plotë). Kërkuësit pretenduan se tre prej gjyqtarëve nuk kishin qenë të paanshëm. Sipas nenit 36(1)(b) dhe (ç) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shih paragrafin 27 më sipër), çdo gjyqtar që ka deklaruar publikisht qëndrimin e tij ndaj çështjes ose paanshmëria e tij vihet në dyshim për shkaqe të tjera duhet të vetëpërjashtohet nga çështja. Në mënyrë që gjykatat të krijojnë te publiku besimin e nevojshëm, duhet të merren parasysh edhe çështjet e organizimit të brendshëm (shih *Piersack kundër Belgjikës*, 1 tetor 1982, § 30, Seria A nr. 53 dhe *Harabin*, cituar më lart, § 132).

60. Edhe sikur të supozohet që tre gjyqtarët në konflikt nuk mund të kujtonin që kishin qenë në trupën e gjykimit të Gjykatës së Lartë në vitin 2012, ata duhej të ishin bërë të vetëdijshëm për përfshirjen e tyre të mëparshme në të njëjtën çështje, kur kishin studiuar dosjen e çështjes, e cila përfshinte vendimin në fjalë. Gjykata Kushtetuese nuk zhvilloi një seancë gjyqësore publike në çështjen e kërkuësve, as nuk i njoftoi ata paraprakisht për përbërjen e trupit gjykues që do ta shqyrtonte çështjen në një seancë të mbyllur. Edhe pse kërkuësit me sa duket ishin të vetëdijshëm për përbërjen e zakonshme të trupit gjykues, ata nuk u informuan për ndonjë

mungesë të mundshme ose për faktin që tre gjyqtarët e kishin përjashtuar veten. Në këtë drejtim, dhe në lidhje me kundërshtimin e Qeverisë, se kërkuesit nuk e kishin kërkuar përjashtimin e tre gjyqtarëve, Gjykata vëren se ata ishin vënë në dijeni për përbërjen vetëm kur u ishte dorëzuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, kërkuesve nuk iu dha mundësia të bënin parashtrime mbi çështjen e paanshmërisë në kohën e duhur (shih *Sigríður Elin Sigfúsdóttir kundër Islandës*, nr. 41382/17, § 35, 25 shkurt 2020). Prandaj, kundërshtimi paraprak i Qeverisë, në lidhje me këtë aspekt duhet të rrëzohet.

61. Në disa çështje të saj, Gjykata, kur trajton probleme që lidhen me parimin e paanshmërisë gjyqësore, u është referuar Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, të cilat parashikojnë që rrethanat e jashtëzakonshme mund të kërkojnë një shmangie nga parimi i paanshmërisë. Në mënyrë specifike, doktrina e domosdoshmërisë e cituar në Parimet e Bangalores i mundëson një gjyqtari, i cili përndryshe do të ishte i përjashtuar, që të dëgjojë dhe të vendosë për një çështje vetëm nëse e kundërta do të rezultonte në padrejtësi – veçanërisht, kur një shtyrje ose gjykim i pavlefshëm do të shkaktonte vështirësi të mëdha. Këto raste përshkruhen si “të rralla dhe të veçanta” (shih referencat në paragrafin 40 më sipër). Komisioni i Venecias, duke iu referuar kësaj doktrine, ka menduar se ajo zbatohet vetëm nëse përjashtimi mund të rezultojë në mohim të drejtësisë, duke vënë në dukje se një kufi i gjerë vlerësimi për vendimmarrjen e një çështjeje mund të argumentohet në favor të përjashtimit. Megjithatë, në situata kur pyetja kushtetuese është mjaft e qartë dhe shqyrtimi gjyqësor nuk përfshin ndonjë gjykim vlerësues nga gjyqtari përkatës, duhet të mbizotërojnë funksionimi efektiv i një gjykate kushtetuese si një institucion demokratik (shih *Alvina Gyulumyan dhe të tjerë kundër Armenisë*, nr. 25240/20 (vendim), §§ 52 dhe 81, 21 nëntor 2023).

62. Në çështjen në fjalë, problemi i paanshmërisë së gjyqtarëve nuk u ngrit *proprio motu* dhe, si rezultat, Gjykatës nuk i është dhënë asnjë informacion nëse është diskutuar brenda Gjykatës Kushtetuese ose mbi çfarë arsyes është vendosur që të vazhdojë me të njëjtën përbërje. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të sugjerojë se gjyqtarët B.I., G.D. dhe F.L. vlerësuan mundësinë e tërheqjes nga çështja ose që ata e kishin informuar kryetarin e Gjykatës Kushtetuese për përfshirjen e tyre të mëparshme në proceset përkatëse, edhe pse rregullat përkatëse procedurale dukej se parashikonin një mundësi të tillë (shih paragrafin 28 më lart; dhe *Golubović kundër Kroacisë*, nr. 43947/10, § 58, 27 nëntor 2012).

63. Si rezultat, Gjykata Kushtetuese nuk e shfrytëzoi mundësinë për të përcaktuar nëse arsyet e pretenduara për mungesën e paanshmërisë së tyre justifikonin përjashtimin e tre gjyqtarëve apo nëse aftësia e gjykatës për të vendosur për çështjen duhej të ishte marrë në konsideratë edhe në rrethana të tilla. Prandaj, Gjykata mban qëndrimin se Gjykata Kushtetuese nuk bëri vlerësimin e nevojshëm procedural.

c) Kuorumi i Gjykatës Kushtetuese dhe vendet e lira në trupin gjykues të saj

64. Gjykata vëren se një nga arsyet që kontribuoi në faktin pse Gjykata Kushtetuese u mblodh në një trup gjykues të paplotë prej gjashtë gjyqtarësh në çështjen e kërkuesve, duke e komplikuar kështu procesin e saj të vendimmarrjes, ishin vonesat e shumta në zgjedhjen ose emërimin e anëtarëve të saj të rinj (shih, gjithashtu, *Meli dhe Swinkles Family Brewers kundër Shqipërisë*, nr. 41373/21 dhe 48801/21, § 65, 16 korrik 2024).

65. Të tre gjyqtarët e kundërshtuar nga kërkuesit për mungesën e paanshmërisë së tyre ishin emëruar në të njëjtën kohë, pas përfundimit të mandatit të tyre si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 20 më sipër). Gjykata pranon se u takon Shteteve Anëtare të përcaktojnë kriteret për emërimin e anëtarëve të gjykatave më të larta. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, brenda rregullimit përkatës institucional në nivel kombëtar, mund të lindin probleme në rast të emërimit të njëkohshëm të shumë gjyqtarëve (të mëparshëm ose në detyrë) të Gjykatës së Lartë në Gjykatën Kushtetuese. Duke pasur parasysh që Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë gjyqtarë, me një kuorum prej gjashtë gjyqtarësh, dhe që nuk ka dispozita për gjyqtarë zëvendësues ose rregullime të ngjashme, këto emëime mund të pengojnë vendimmarrjen e saj

kur lindin çështje paanshmërie. Kjo është e qartë nga fakti se në shumicën e rasteve të ankimeve individuale, ankimi kushtetues ngrihet kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë si gjykata më e lartë e zakonshme.

66. Një çështje tjetër relevante ka të bëjë me kohën që iu desh autoriteteve kombëtare emëruese për të emëruar gjyqtarë të rinj në Gjykatën Kushtetuese pas përfundimit të mandatit të anëtarëve ekzistues. Gjykata vëren se kur u gjykua çështja e kërkuarve, mandati i gjyqtarëve S.B. dhe V.K. kishte mbaruar më shumë se pesëmbëdhjetë muaj më parë. Pasardhësit e tyre u emëruan vetëm katër vjet e shtatë muaj më vonë dhe tre vjet e gjashtë muaj më vonë, përkatësisht (shih paragrafët 22 dhe 23 më sipër). Vonesa të ngjashme ndikuan në emërimin e të gjithë gjeneratës së ardhshme të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, pasi vetëm një nga gjyqtarët në detyrë në kohën e reformave në drejtësi të vitit 2016 u konfirmua nga organet e vetingut. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, u bë e vështirë për Gjykatën Kushtetuese të vlerësonte, nëse gjykimi i çështjes aktuale mund të ishte shtyrë derisa ajo gjykatë të arrinte një kuorum pa pjesëmarrjen e tre gjyqtarëve në konflikt, duke marrë parasysh, gjithashtu, se çështja kishte qenë në pritje për një vit e gjysmë.

67. Si rezultat i dorëheqjeve dhe/ose shkarkimeve nga organet e vetingut, Gjykata Kushtetuese nuk pati kuorum për shqyrtim me trup gjykues të plotë nga 23 marsi 2018 deri më 23 dhjetor 2020 (shih paragrafin 24 më sipër).

68. Gjykata Kushtetuese nuk i trajtoi këto aspekte në vendimmarrjen e saj, pasi këta ishin faktorë me natyrë strukturore dhe institucionale dhe nuk mund t'u atribuohen në asnjë mënyrë kërkuarve.

d) Konkluzion

69. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme që Gjykata të dalë në përfundimin se proceset para Gjykatës Kushtetuese nuk kishin garancitë e nevojshme të paanshmërisë. Ky konkluzion bazohet në ekzistencën e frikës së justifikuar objektivist, në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarëve B.I., G.D. dhe F.L., dhe mostrajtimin e duhur të këtij problemi nga gjykata. Mangësitë strukturore që lidhen me plotësimin në kohë të vendeve të lira në trupin e saj gjykues kontribuan në situatën ku u gjend ajo gjykatë gjatë vendimmarrjes për çështjen e kërkuarve.

70. Për arsyet e përcaktuara më sipër, Gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të Qeverisë dhe konstaton se në proceset e brendshme nuk u respektua e drejta e kërkuarve për një seancë gjyqësore nga një gjykatë e paanshme. Në këto rrethana, është gjetur shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

71. Kërkuarët u ankuan, gjithashtu, sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shkelje të së drejtës së tyre për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe, sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, për ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre.

72. Duke pasur parasysh gjetjen e saj në lidhje me të drejtën e kërkuarve për një gjykatë të paanshme, sipas nenit 6 § 1 (shih paragrafin 70 më sipër), Gjykata vëren se kërkuarët tani kanë mundësi për të kërkuar rihapjen e proceseve para Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 76 më poshtë). Në parim, kjo mundëson shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuarve, sipas Konventës nga një gjykatë e paanshme. Në këto rrethana dhe në përputhje me rolin e saj plotësues, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankimet e mbetura të kërkuarve në këtë moment. Për ata është e hapur mundësia që të depozitojnë një kërkesë të re në Gjykatë, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimet e tyre kushtetuese në nivel kombëtar.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

73. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

74. Kërkuesit kërkuan 6.000.000 euro (EUR) për dëmin pasuror dhe 100.000 euro për dëmin jopasuror.

75. Qeveria parashtrroi që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

76. Gjykata përsëriti që një vendim gjyqësor ku ajo gjen shkelje të Konventës vendos ndaj Shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të korrigjuar pasojat e saj. Nisur nga natyra e ankimeve të kërkuesve dhe të shkeljeve të gjetura, Gjykata përsëriti, ashtu siç ka bërë në shumë çështje të mëparshme ku ka gjetur që proceset e brendshme gjyqësore kanë shkelur Konventën, se forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për shkeljet e gjetura do të ishte rihapja e proceseve gjyqësore të brendshme (krahaso *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 144-45, 13 dhjetor 2022). Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 71(c) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i së cilës shtrihet në Republikën e Shqipërisë konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi, për shkak të një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese (shih *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 57 dhe 149, 4 tetor 2022).

77. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar nga kërkuesit. Prandaj ajo e refuzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesit duhet të kenë pësuar dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së gjetur. Duke e bërë vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç e kërkon neni 41 i Konventës, ajo i cakton bashkërisht kërkuesve shumën prej 3.600 EUR për dëmin jopasuror.

B. Kosto dhe shpenzime

78. Gjithashtu, kërkuesit pretenduan 5,730 euro për kosto dhe shpenzime të kryera në Gjykatë.

79. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim.

80. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve, vetëm për atë që provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në këtë çështje, duke pasur parasysh dokumentet dhe kriteret e mësipërme, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'u caktojë kërkuesve bashkërisht shumën prej 4000 EUR, për të mbuluar kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet atyre.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Vendos* që të bashkojë me themelin kundërshtimitin paraprak të Qeverisë, në lidhje me faktin që kërkuesit nuk i kishin kundërshtuar gjyqtarët, të cilët ata i konsideronin të anshëm, dhe *e rrëzon* atë;

2. *Shpall* të pranueshëm ankimin e kërkuesve, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën për një gjykatë të paanshme;

3. *Shprehet* që është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, për shkak të mungesës së paanshmërisë së Gjykatës Kushtetuese;

4. *Shprehet* që nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e tjera;

5. *Vendos*:

a) që Shteti i paditur të paguajë, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 44 të Konventës, shumat e mëposhtme që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 3600 EUR (tre mijë e gjashtë qind euro) çdo kërkuesi për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;

ii. 4000 EUR (katër mijë euro) EUR, bashkërisht kërkuesve, për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'iu ngarkohet atyre;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje;

6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 26 gusht 2025, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Ioannis Ktistakis
PRESIDENT

Milan Blaško
KANCELAR